

L I G J
Nr.8509, datë 7.7.1999

**PËR MIRATIMIN E “MARRËVESHJES SË KREDISË TË ZHVILLIMIT NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM
(IDA) PËR “PROGRAMIN E RREGULLIMIT STRUKTUROR”**

Në mbështetje të neneve 121 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Miratohet “Marrëveshja e Kredisë së Zhvillimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për “Programin e rregullimit strukturor”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.2419, datë 19.7.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

NUMRI I KREDISË 3221 ALB

MARRËVESHJE KREDIE ZHVILLIMI
(kredia për rregullimin strukturor)

MARRËVESHJE, datë 24.6.1999, midis Shqipërisë (Huamarrësi) dhe **SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (Shoqata)**.

Meqë : (A) Shoqata ka marrë një letër datë 12.5.1999 nga Huamarrësi ku përshkruhet një program veprimesh, objektivash dhe politikash projektuar për të arritur rregullime strukturore të ekonomisë së Huamarrësit (më tej quajtur Program), deklarohet rënia dakord e Huamarrësit për ekzekutimin e Programit, dhe kërkohet asistencë nga Shoqata në mbështetjen e Programit gjatë ekzekutimit

(C) Në bazë, ndër të tjera, të pohimeve të mësipërme, Shoqata ka vendosur të sigurojë një asistencë të tillë për Huamarrësin, në mbështetje të Programit, nëpërmjet dhënies së kredisë në dy transhe si parashikohet në vijim;

PRANDAJ palët kontraktuese bien dakord për sa vijon:

NENI I
Kushtet e Përgjithshme; Përkufizimet

Seksioni 1.01. “Kushtet e Përgjithshme që i përkasin Marrëveshjeve mbi Kreditë për Zhvillim” të Shoqatës, nënshkruar më datën 1 Janar 1985, (ndryshuar në 2 Dhjetor 1997), me përmirësimet e bëra më poshtë (Kushtet e Përgjithshme) përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje:

(a) Seksioni 2.01, paragrafi 9, i ndryshuar do të lexohet:

“Projekt” do të thotë programi, referuar Hyrjes së Marrëveshjes së Kredisë së Zhvillimit, në mbështetje të se cilës bëhet kredia.”;

(b) Seksioni 4.01, i ndryshuar do të lexohet:

“Veçse kur Huamarrësi dhe Shoqata do të bien dakord ndryshe, tërheqjet nga llogaria e Kredisë do të bëhen në monedhën e llogarisë së depozitës specifikuar në Seksionin 2.02 të Marrëveshjes së Kredisë së Zhvillimit.”;

(c) Seksioni 5.01 i ndryshuar do të lexohet:

“Huamarrësi do të ketë të drejtë të tërheqë të ardhurat e kredisë nga Llogaria e Kredisë në përputhje me klauzolat e Marrëveshjes së Kredisë së Zhvillimit dhe Kushteve të Përgjithshme”;

(d) Fjalja e fundit e Seksionit 5.03, është fshirë;

(e) Seksioni 9.06 (c), i ndryshuar do të lexohet:

“(c) Jo më vonë se 6 muaj pas Datës së Mbylljes ose të një date të mëvonshme si mund të bihet dakord për këtë qëllim midis Huamarrësit dhe Shoqatës, Huamarrësi do të përgatisë dhe furnizojë Shoqatën një raport, për atë qëllim dhe me aq detaje si Shoqata në mënyrë të arësyeshme do të kërkojë, mbi ekzekutimin e programit referuar Hyrjes së Marrëveshjes së Kredisë së Zhvillimit, kryerjen nga Huamarrësi dhe Shoqata të detyrimeve të tyre respektive sipas Marrëveshjes së Kredisë së Zhvillimit dhe plotësimin e qëllimeve të kredisë.”; dhe

(f) Seksioni 9.04, është fshirë dhe Seksionet 9.05, 9.06 (si modifikuar më lart), 9.07 dhe 9.08 janë rinumëruar, respektivisht Seksioni 9.04, 9.05, 9.06 dhe 9.07.

Seksioni 1.02. Përveç rasteve të caktuara, termat e përcaktuara në Kushtet e Përgjithshme dhe në Hyrjen e kësaj Marrëveshjeje kanë përcaktimet e theksuara dhe termat plotësuese që pasojnë kanë këto përcaktime:

(a) “Llogaria Depozitës” do të thotë llogaria referuar Seksionit 2.02 (a) të kësaj marrëveshjeje;

(b) “Privatizimi” do të thotë shitja e më shumë se 51 % e aksioneve të ndërmarrjeve përfshirë kontrollin manaxhues ose shitja e aseteve nëpërmjet likuidimit të ndërmarrjeve nëpërmjet vendimeve administrative, vendimeve të gjyqit ose nga autoritetet përkatëse lokale ose ekzekutimit të një kontrate afatgjatë qiramarrjeje; për qëllimet e këtij përcaktimi, shitje do të quhet të bëhet vetëm sipas ekzekutimit të kontratës së shitjes së aksioneve dhe aseteve të lart përmendura;

(c) “Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme” do të thotë ndërmarrjet e specifikuara në listën e datës 13 Mars 1999 dhënë Shoqatës, më përjashtim të ndërmarrjeve në sektorin e mbrojtjes dhe kulturës si specifikohet në listën e sipër përmendur;

(d) “NCB” do të thotë Banka Kombëtare Tregëtare e huamarrësit e themeluar sipas ...;

(e) “Plani i Veprimit Anti-Korrupsion” do të thotë plani i veprimit anti-korrupsion i shpallur nga Këshilli i Ministrave sipas Vendimit Nr.515 datë 13 Gusht 1998.

NENI II

Kredia

Seksioni 2.01. Shoqata pranon t’i japë Huamarrësit, sipas kushteve dhe konditave të përcaktuara ose të përmendura në Marrëveshjen e Kredisë së Zhvillimit, një shumë në valuta të ndryshme baras me ekuivalentin e tridhjetë e tre milion e dyqint mijë të Drejta të Posaçme Tërheqje (SDR 33,200,000).

Seksioni 2.02. (a) Huamarrësi, para se t’i drejtojë kërkesën e parë për tërheqje Shoqatës, do të hapë dhe pastaj do të mbajë në bankën e saj qendrore, një llogari depozite në dollarë me terma dhe kushte të kënaqëshme për Shoqatën. Të gjitha tërheqjet nga llogaria e kredisë do të depozitohen nga Huamarrësi në Llogarinë Speciale.

(b) Në përputhje me kushtet e paragrafëve (c) dhe (d) të këtij Seksioni, Huamarrësi do të ketë të drejtën të përdorë të ardhurat nga tërheqjet e Kredisë nga Llogaria e Kredisë dhe t’i depozitojë në Llogarinë e Depozitës në mbështetje të programit.

(c) Huamarrësi merr përsipër që të ardhurat e kredisë nuk do të përdoren për financimin e shpenzimeve përjashtuar sipas kushteve të Tabelës 1 të kësaj marrëveshjeje. Në se Shoqata do të përcaktojë në ndonjë kohë se ndonjë e ardhur e kredisë është përdorur për të bërë një pagesë për shpenzime të përjashtuara, Huamarrësi menjëherë pas njoftimit të Shoqatës, do të (i) depozitojë në Llogarinë e Depozitës një shumë të barabartë me këtë pagesë, ose (i) në se Shoqata do të kërkojë kështu, do t’i kthejë k[ë] shumë Shoqatës. Shumat e kthyera Shoqatës sipas kësaj kërkesë do të kreditohen në Llogarinë e Kredisë për anulim.

(d) Asnjë tërheqje nuk do të bëhet nga Llogaria e Kredisë pasi të ardhurat nga tërheqjet e kredisë nga llogaria e kredisë të kenë arritur shumën e ekuivalentit të 14,740,000 SDR, përveç rasteve

kur Shoqata do të jetë e kënaqur, pas këmbimit të pikpamjeve siç përshkruhet në Seksionin 3.01 të kësaj Marrëveshjeje bazuar në evidenca të pranueshme për Shoqatën: (i) më progresin e arritur nga huamarrësi në zbatimin e Programit; dhe (ii) që veprimet e përshkruara në Tabelën 2 të kësaj marrëveshjeje janë ndërmarrë. Në se, pas këmbimit të pikpamjeve të sipër përmendura, Shoqata do t'i njoftojë Huamarrësit se progresi i arritur dhe veprimet e ndërmarrë, nuk janë të kënaqeshme dhe, brenda 90 ditëve pas këtij njoftimi, Huamarrësi nuk ka arritur progresin dhe ndërmarrë veprimet e kënaqshme për shoqatën, pastaj Shoqata mundet, me njoftim Huamarrësit, të anullojë shumën e tërhequr të kredisë ose ndonjë pjesë të saj.

Seksioni 2.03. Data e mbylljes është 31 Dhjetor 2000, ose një datë e mëvonshme e përcaktuar nga shoqata. Shoqata menjëherë do të njoftojë Huamarrësin lidhur me datën e mëvonshme.

Seksioni 2.04. (a) Huamarrësi do t'i paguajë Shoqatës një pagesë angazhimi mbi shumën kryesore të Kredisë së patërhequr nga koha në kohë, në një përqindje që do të vendoset nga Shoqata më 30 Qershor të çdo viti, por duke mos tejkaluar gjysëm përqind (1/2 të 1 %) në vit.

(b) Pagesa e angazhimit do të fillojë : (i) gjashtëdhjetë ditë nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje (data e shtimit) deri në datat në të cilat shumat do të tërhiqen nga Huamarrësi nga Llogaria e Kredisë ose do të anulohen; dhe (ii) sipas përqindjes së caktuar më 30 Qershor menjëherë para datës së fillimit të shtesës ose me një përqindje tjetër që pastaj mund të përcaktohet nga koha në kohë në përputhje me paragrafin (a) më sipër. Vlera e caktuar më 30 Qershor në çdo vit do të përdoret nga data e ardhëshme e pagesës në atë vit të përcaktuar në Seksionin 2.06 të kësaj Marrëveshjeje.

(c) Pagesa e angazhimit do të paguhet: (i) në vende të tilla që në mënyrë të aresyeshme do të kërkojë Shoqata; (ii) pa kufizime të cfarëdo lloji që mund të vendosen nga, ose në territorin e Huamarrësit; dhe (iii) në monedha të tjera të pranueshme që nga koha në kohë mund të përcaktohen ose të zgjidhen në përputhje me dispozitat e këtij Seksioni.

Seksioni 2.05. Huamarrësi do t'i paguajë Shoqatës një pagesë shërbimi me një përqindje prej tre të katërtat e një përqind (3/4 e 1 %) në vit të shumës së përgjithshme të kredisë të tërhequr dhe të papaguar nga koha në kohë.

Seksioni 2.06. Pagesat e angazhimit të shërbimeve do të paguhen dy herë në vit në 15 Prill dhe 15 Tetor të çdo viti.

Seksioni 2.07. (a) Në përputhje me paragrafët e mëposhtëm (b), (c) dhe (d), Huamarrësi do të ripaguajë shumën e përgjithshme të kredisë në pagesa gjysmëvjetore çdo 15 Prill dhe 15 Tetor duke filluar nga 15 Tetor 2009, dhe duke përfunduar më 15 Prill 2039. Të gjitha pagesat deri dhe duke përfshirë pagesën më 15 Prill 2019 duhet të jenë një përqind (1 %) të shumës së përgjithshme, dhe çdo pagesë pas kësaj date do të jetë dy përqind (2 %) e shumës së përgjithshme.

(b) Kurdo që : (i) prodhimi i përgjithshëm kombëtar për frymë i Huamarrësit, i përcaktuar nga Shoqata, tejkalon për tre vite rresht nivelin vjetor të caktuar nga Shoqata për kushtëzimin e përdorimit të burimeve të Shoqatës; dhe (ii) Banka do ta konsiderojë Huamarrësin të besueshëm për t'i dhënë kredi, Shoqata, pas shqyrtimit dhe miratimit nga Drejtoret Ekzekutive të Shoqatës dhe pasi ata të kenë shqyrtuar zhvillimin e ekonomisë së Huamarrësit, mund të ndryshojë kushtet e ripagimit sipas dispozitave të paragrafit të mësipërm (a):

(A) Duke i kërkuar Huamarrësit të paguajë dyfishin e pagesës deri sa të shlyejë gjithë shumën e kredisë; dhe

(B) Duke i kërkuar Huamarrësit të fillojë shlyerjen e shumës së përgjithshme të kredisë si pagesë e datës së gjysmës së parë të vitit referuar në paragrafin (a) të mësipërm që është gjashtë muaj (6) ose më shumë pas datës në të cilën Shoqata njofton Huamarrësin se kanë ndodhur ngjarjet e theksuara në këtë paragraf (b), duke shtuar se do të ketë një periudhë minimale favorizuese prej pesë (5) vjetësh për këtë pagesë të shumës së përgjithshme.

(c) Në qoftë se kërkohet nga Huamarrësi, Shoqata mund t'i ndryshojë modifikimet referuara në paragrafin (b) më sipër, kështu që në vend të një pjese të pagesës ose të të gjithë shtesës së pagesës, të paguhet interesi me një përqindje vjetore të caktuar me Shoqatën mbi shumën e përgjithshme të Kredisë së tërhequr dhe ende të papaguar nga koha në kohë në qoftë se sipas mendimit të Shoqatës këto shqyrtime nuk do të ndryshojnë elementin e kredisë së dhuruar sipas modifikimeve të pagesës së lartpërmendura.

(d) Në qoftë se në çdo kohë pas modifikimit të kushteve sipas paragrafit (b) më sipër, Shoqata përcakton se gjendja ekonomike e Huamarrësit është keqësuar dukshëm, Shoqata, në se i kërkohet nga Huamarrësi, mund të bëjë modifikime të tjera të kushteve të pagesës për t'iu përshtatur afatit të

caktuar të pagesës siç parashikohet në paragrafin (a) me sipër.

Seksioni 2.08. Monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës caktohet si monedha e përdorshme për nevojat e Seksionit 4.02 të Kushteve të Përgjithshme.

NENI III Konventa të Veçanta

Seksioni 3.01. (a) Huamarrësi dhe Shoqata herë pas here, me kërkesë të secilës palë, do të shkëmbejnë pikëpamjet mbi progreset e arritura në zbatimin e Programit dhe veprimeve të specifikuara në Tabelën 2 të kësaj Marrëveshje.

(b) Para një shkëmbimi të tillë pikëpamjesh, Huamarrësi do t'i furnizojë Shoqatës për rishikimin e saj dhe komente një raport mbi progresin e arritur në zbatimin e Programit, në detaje të tilla si Shoqata arsyeshëm do t'i kërkojë.

(c) Pa limit sipas klauzolave të paragrafit (a) të këtij Seksioni, Huamarrësi do të shkëmbejë pikëpamje me Shoqatën mbi çdo veprim të propozuar për t'u ndërmarrë pas disbursimit të Kredisë i cili do të ketë efekt materialisht të kundërt me objektivat e Programit, ose çdo veprim tjetër sipas Programit, përfshirë çdo veprim të specifikuar në Tabelën 2 të Marrëveshjes.

Seksioni 3.02. Me kërkesë të Shoqatës, Huamarrësi do të :

(a) ketë Llogarinë e Depozitës të revizionuar në përputhje me parime të përshtatshme rëvizionimi të përdorura në mënyrë të vazhdueshme, nga revizor[të pavarur e të pranueshëm për Shoqatën;

(b) të pajisë Shoqatën menjëherë sa të jenë të gatshme, por në asnjë rast më vonë se katër muaj pas datës së kërkesës së Shoqatës për një revizionim të tillë, një kopje të certifikuar të raportit të revizionimit nga këta revizore, për atë qëllim dhe në ato detaje si Shoqata do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme; dhe

(c) t'i furnizojë Shoqatës çdo informacion tjetër lidhur me Llogarinë e Depozitës dhe revizionin siç Shoqata do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme.

NENI IV Ngjarje Shtesë për Pezullim

Seksioni 4.01. Në përputhje me Seksionin 6.02 (h) të Kushteve të Përgjithshme, si ngjarje shtesë në vijim është specifikuar, pikërisht, krijimi i një situatë e cila bën të pamundur zbatimin e Programit, ose të një pjese të rëndësishme të tij.

NENI V Përfundimi

Seksioni 5.03. Data 90 ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje përcaktohet për qëllimet e Seksionit 12.04 të Kushteve të Përgjithshme.

NENI VI Përfaqësuesi i Huamarrësit; Adresat

Seksioni 6.01. Ministri i Financave i Huamarrësit është caktuar si përfaqësues i Huamarrësit për qëllimet e seksionit 11.03 të Kushteve të Përgjithshme.

Seksioni 6.02. Adresat e mëposhtme janë përcaktuar për qëllimet e seksionit 11.01 të Kushteve të Përgjithshme:

Për Huamarrësin:
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmoret e Kombit"
Tirana
Abania
Teleks:

4295 Komplan AB
Për Shoqatën:
International Development Association
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America

Adresa telegrafike	Teleks
INDEVAS	248423 (RCA)
Washington D.C.	82987 (FTCC)
	64145 (WUI) ose
	197688 (TRT)

PARA DËSHMITARËVE, palët nënshkruese, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë rënë dakord që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në emrat e tyre përkatës në distriktin Columbia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në datën dhe vitin e lart shënuar për herë të parë.

Shqipëria
Nga
Petrit Bushati
Përfaqësuesi i Autorizuar

SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM

Nga
Julius Varallnay
Nën Presidenti rajonal
Për Europën dhe Azinë Qendrore

TABELA 1 SHPENZIMET QË PËRJASHTOHEN

Për qëllime të Seksionit 2.02 (c) të kësaj Marrëveshje, të ardhurat e kësaj Kredie nuk do të përdoren për të financuar shpenzimet e mëposhtme:

1. shpenzimet në monedhën e Huamarrësit ose për mallrat e shërbimet të furnizuara nga territori i Huamarrësit;

2. shpenzimet për mallrat e shërbimet të furnizuara sipas një kontratë që asnjë nga agjencitë apo institucionet financiare ndërkombëtare përveç Bankës ose Shoqatës nuk e ka financuar apo ka pranuar ta financojë, ose të cilën Banka apo Shoqata do ta financojë apo kanë pranuar të financojnë nëpërmjet një kredie apo huaje tjetër.

3. shpenzimet për mallra të përfshira në grupet e mëposhtme ose nëngrupet e Grupimit Standart Ndërkombëtar Tregtar Rishikimi 3, i botuar nga Kombet e Bashkuara në Artikujt Statistikorë, seria M, nr.34/rish.3 1986 ose ndonjë grup ose nëngrup i mëvonshëm sipas rishikimit të ardhshëm të GSNT, siç i bëhet e ditur Huamarrësit nga Shoqata:

Grupi	Nëngrupi	Përshkrimi i mallit
112	-	Pije alkolike
121	-	Duhan, i papërpunuar, mbeturina duhani
122	-	Duhan i përpunuar me ose pa përmbajtje
zëvendësuesish të duhanit		
525	-	Materiale radioaktive ose përzjerje e tyre
667	-	Materiale radioaktive ose përzjerje të tyre
718	718.7	Reaktore bërthamore, pjesë të tyre, elementë të djegshëm për reaktorët
728	718.43	Makineri e përpunimit të duhanit
897	897.3	Sende të çmuara ari, argjendi, platini, grup metalesh (përfshijë orët dhe kutitë e tyre)

4. Shpenzimet për mallra me synime ushtarake ose paraushtarake, ose për përdorim luksoz;
5. Shpenzimet për mallra të rrezikshme për mjedisin (në këtë paragraf ky term do të thotë prodhime ose importe që ndalohen sipas ligjit të huamarrësit ose të marrëveshjeve ndërkombëtare ku Huamarrësi është palë);
6. Shpenzimet në territoret e çdo vendi që nuk është anëtar i Bankës ose për mallra e shërbime të blëra apo furnizuara prej tyre, për llogari të çdo personi apo organizate, ose çdo lloj importi mallrash, në se pagimi ose importimi është i ndaluar me vendim të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara;
7. Shpenzimet sipas një kontrate në zbatim të së cilës Shoqata përcakton që janë bërë shkelje ose korrupsion nga përfaqësuesit e Huamarrësit ose të përfituesit të kredisë gjatë blerjes ose veprimit të kësaj kontrate, kur Huamarrësi nuk ka ndërmarrë veprimet e duhura të kënaqëshme për Shoqatën për rregullimin e gjendjes.

TABELA 2
VEPRIMET QË LIDHEN ME SEKSIONIN 2.02 (D) TË KËSAJ MARRËVESHJE

Huamarrësi kryen:

- (1) Monitorimin e vazhdueshëm dhe shpalljen e progresit në zbatimin e programit të tij të reformës institucionale dhe qeverisëse dhe bën progres thelbësor në zbatimin e Planit të Veprimit Antikorrupsion në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Shoqatën;
- (2) Kompletimin e marrjes në punë të 50 nëpunësve civilë sipas procedurave të transparencës, konkurrencës, meritave si përcaktohet në legjislacionin e manaxhimit të burimëve njerëzore në një mënyrë të pranueshme për Shoqatën;
- (3) Kompletimin e testit të përshkruar në Artikullin 48 të Ligjit të 28 Dhjetorit 1998 dhe gjithë gjyqtarët që nuk kalojnë testin shkarkohen nga detyra nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në përputhje me të njëjtin Artikull;
- (4) Zbatimin e Programit të Reformës së Fakultetit të Drejtësisë së Universitetit të Tiranës së Huamarrësit në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Shoqatën;
- (5) Kompletimin e Privatizimit ose likuidimit të minierave të vogla të bakrit dhe kromit si përcaktohet në listën e minierave të vogla në këta sektorë, të datës 12 Mars 1999, dhënë Shoqatës;
- (6) Kompletimin e Privatizimit ose likuidimit të gjithë Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme të mbetura;
- (7) Finalizimin e shitjes së aksioneve të BKT pronarëve të rinj, marrjen e pagesës nga shitja dhe sigurimin e licensës së re nga Banka e Shqipërisë për BKT;
- (8) Kalimi me ligj i projektligjeve mbi transaksionet e siguruara ashtu siç është rënë dakord me Shoqatën;
- (9) Kompletimin e fazës së parë të regjistrimit në 1000 nga totali i njësive kadastrale të Huamarrësit si përcaktohet në Ligjin N0.7483 datë Korrik 1994 dhe ndryshuar nga Ligji Nr.8090 i Marsit 1996 të Huamarrësit; dhe
- (10) Mbajtjen e vazhdueshme të programit të politikës makroekonomike në përputhje me objektivat e Programit si përcaktohet në bazë të indikatorëve të rënë dakord me Shoqatën.